



*Handwritten signature*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 6716 Prot

Tiranë, më 09.12. 2014

U R D H Ë R

Nr. 529 Datë 03/12/2014

PËR  
MIRATIMIN E KONTRATËS PËR NDJEKJEN E STUDIMEVE TË  
SPECIALIZIMIT AFATGJATË NË FUSHËN E MJEKËSISË PRANË  
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 13 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 12.11.2014 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2014-2015”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e kontratës për ndjekjen e studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë pranë Universitetit të Mjekësisë midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe **mjekut/mjekes** të shpallur fitues për kuotat e mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë që i bashkëlidhet këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**  
**ILIR BEQAT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
MINISTRI

Nr. 6716 / Prot. 1

Tiranë, më 09 / 12 / 2014

K O N T R A T Ë

P Ë R

NDJEKJEN E STUDIMEVE TË SPECIALIZIMIT AFATGJATË NË FUSHËN E  
MJEKËSISË PRANË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË

Sot, më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, lidhet kjo kontratë midis palëve :

Ministrisë së Shëndetësisë \_\_\_\_\_

(grada, emër, mbiemër)

dhe mjekut/mjekes \_\_\_\_\_, me adresë: \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

me letërnjoftim nr. \_\_\_\_\_, madhor/e dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me detyrë \_\_\_\_\_

për :

ndjekjen e studimeve specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, në programin e studimit \_\_\_\_\_, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë , në \_\_\_\_\_

për periudhën \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, deri më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_.

Me vullnet dhe dëshirë të lire, palët bien dakord për sa më poshtë :

